

VENDIM
Nr. 314, datë 2.6.2021

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT), QË, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË SI AUTORITET SHITËS, TË KRYEJË PROCEDURAT E ANKANDIT PUBLIK TË ARTIKUJVE TË NDRYSHËM PËR SKRAP

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 28, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit), që, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë si autoritet shitës, të kryejë procedurat e ankandit publik të artikujve të ndryshëm për skrap, deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.
 2. Kryeministria t’i dorëzojë Ministrisë së Mbrojtjes të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e procedurës së ankandit publik, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.
 3. Ngarkohet struktura përgjegjëse në Kryeministri për mbikëqyrjen e kryerjes së procedurës së ankandit publik, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi.
 4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe